



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

Pranuar - Primjencë Mëi/Dana ..... 20.12.2011 Vit./Gj.			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01-013/4715			

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 40 paragrafi 2 pika a.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35 paragrafi 2 pika a) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 28.12.2011 aprovon këtë:

V E N D I M  
PËR SHFUQIZIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E  
ADMINISTRATËS KOMUNALE

Neni 1

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, SHFUQIZON Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Komunale numër 01-013/4715 të datës 01.10.2008 me çka pushojnë të vlejshme dispozitat e Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Komunale.

Neni 2

Shfuqizimi i Rregullores nga neni 1 i këtij vendimi rrjedh si pasojë e pengesave ligjore lidhur me zbatimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Komunale, pasi që e njëjta bie ndesh me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës së Vitisë numër 01-013/491 të datës 21.04.2011 dhe si e tillë defakto dhe dejure është inekzistente.

Neni 3

Më shfuqizimin e Rregullores mbi Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Komunale nga neni 1 i këtij vendimi pushon së ekzistuari Rregullorja për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Komunale numër 01-013/4715 të datës 01.10.2008, dhe si e tillë juridikisht nuk prodhon efekte juridike.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

O1.Nr. \_\_\_\_\_  
Viti, 28.12.2011

KRYESUESI I KUVENDIT  
Skenderbe Hebib



*Skenderbe Hebib*